

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

ID 1.7 *“Gaz natyror aromatik ose GLN, pervec rasteve kur veprimtaria eshte e lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave”*

ID 1.10 *“Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane”*

(Industritë energjitike, pika 1.7 dhe 1.10, sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

SUBJEKTI: “D I E Z E L A” Sh.p.k.

NIPT: K91420010C

VENDNDODHJA: Tiranë, Rruga "Ali Demi", Shkozë, përballë TV News24, Karburanti Nr.27.

1. PROFILI I KOMPANISE

Subjekti “DIEZELA” Sh.p.k., me administrator **Brikena Mersinaj**, i regjistruar në QKB me 20/02/2009, me NIPT K91420010C dhe me vendndodhje ne **Tiranë, Rruga "Ali Demi", Shkozë, përballë TV News24, Karburanti Nr.27.**

Subjekti do te aplikojë për leje mjedisi Tip B për aktivitetin:

Industrië energjitike

ID 1.7 “Gaz natyror aromatik ose GLN, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave”

ID 1.10 “Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane”

Referuar shtojcës 1 të ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

-Objektivi i parë i këtij aktiviteti do të jetë të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore këtij instalime të cilat janë:

- Emetimet në ajër dhe zhurmat;
- Ndikimi në florë/faunë;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim në cilësinë e jetës në qendrat e banuara;
- Ndikim në rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim në peizazhin e zonës;

-Objektivi i dytë i këtij aktiviteti është gjetja e alternativave që janë më miqësore me mjedisin.

3. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TE AKTIVITETIT

Operatori **“DIEZELA” Sh.p.k**, do te zhvilloje aktivitetin ne adresen **Tiranë, Rruga "Ali Demi", Shkozë, përballë TV News24, Karburanti Nr.27.**

Ambjenti ku do te zhvillohet veprimtaria **“Pike karburanti”** eshte marre me qera dhe operatori **“DIEZELA” SH.P.K.** posedon kontraten e qerese. Siperfaqja totale eshte **320 m²**, nga te cilat **36 m²** jane siperfaqe e objektit, ndersa **284 m²** jane siperfaqe e sheshit te ndertimit.

Pika e karburantit eshte e perbere nga:

- Klubi
- Ambientet perkatese: ambienti I punetoreve si dhe territori qe ze pika e karburantit ne sherbim te tij.
- Autogazi
- Pompa
- Gjeneratori
- Kamera dhe instalimi I tyre
- Tabela e cmimeve

Zona e perzgjedhur per ushtrimin e ketij aktiviteti eshte e pershtatshme per kete lloj aktiviteti duke para parasysh perparesite si:

- Furnizimi me uje;
- Furnizimi me energji elektrike
- Lehtesi ne aksesim nga automjetet (cisternat, automjetet qe furnizohen, zjarrefikeset dhe ambulancat)

Me poshte jepen koordinatat sipas sistemit Gauss Kruger te vendodhjes se ushtrimit te aktivitetit.

VENDNDODHJA E TENDES		
Nr.	X	Y
1.	4405522.31	4578191.86

VENDNDODHJA E KLUBIT, DEPOZITAVE DHE AUTOGAS		
Nr.	X	Y
1.	4405529.84	4578208.55



4. PROCESI TEKNOLOGJIK

Depozitimi dhe shitja e karburanteve perben nje proces kompleks dhe parashikon mbajtjen e nje sere parametrash rigoroze ne skemen teknologjike si dhe nje varg masash suplementare per te garantuar nje pune normale ne objekt, pa rreziqe per punen e jeten e personelit si dhe duke ruajtur ambjentin nga ndotja e mjedisit. Objekti eshte projektuar dhe zbatuar ne baze te kushteve teknike dhe normave te projektimit per pikat e shitjes se karburantit brenda dhe jashte vijave te verdha te zonave urbane dhe ne rruget kombetare e autostrada.

Rezervuaret e karburantit, gazit te lengshem, pompat, distributoret dhe cdo pajisje tjeter teknologjike sigurohet nga investitori. Ato duhet te jene te pajisur me certifikate cilesie qe siguron nje pune pa rreziqe sipas kerkesave dhe rregullave ne fuqi.

Furnizimi I rezervuareve me karburant:

Behet me ane te autoboteve te posacem per kete qellim. Jane te ndare per karburante te lengshem dhe ato te gazte. Keto mjete jane te pajisur me sinjalistiken e transportimit te lendeve djegese fosile sipas llojit.

Shitja e karburanteve

Shitja e karburanteve realizohet me ane te distributorit me pompe dhe pistolete. Zgjedhja e distributorit eshte bere sipas kerkesave bashkekohore qe sigurojne dhenie konstante te sasise, regjistrimin perkates dhe sigurine ne pune.

Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;

Duke gene se instalimi ne fjale nuk i perket aktivitetit te prodhimit, si rrjedhim nuk ka perdorim te lendeve te para por, ka vetem furnizim te pikes me karburant dhe tregetim te tyre.

- **Lende te para** (per shitje) → Gazoil, Benzine, GLN.

Burimi: autobote te specializuara per kete qellim.

Sasia: ne varesi te kerkesave te klienteve.

- **Lende ndihmese** → Uje, Energji.

1. *Uji* do te merret nga rrjeti, sepse do te perdoret vetem per perdorimin e stafit, gjithashtu edhe shkarkimi nga nyjet sanitare do te kryhet ne rrjeti.

2. *Energjia elektrike* qe do te perdoret vetem per ndricimin e jashtem dhe te brendshem te objektit. Energjia elektrike do te merret nga rrjeti i zones ne baze te kontrates qe operatori ka lidhur me OSHE.

Kushtet e magazinimit te lendes se pare

Rezervuaret duhet te jene te pajisur me certificate cilesie, qe siguron nje pune pa rreziqe sipas kerkesave te rregulloreve ne fuqi.

-Cdo punim duhet te kryhet duke respektuar normat dhe standardet e percaktuara nga Komuniteti European.

5. NDIKIMET NE MJEDIS DHE MASAT QE DUHET TE NDERMERREN

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	Masat zbutese qe duhet te ndermerren
TOKE	Ndikim ne ndotje te tokes	Materialet jane te standarteve bashkekohore dhe perdoret lende djegese e nje cilesie te mire. Si pasoje e emisioneve te mundshme si vajra dhe karburante qe mund te emetohen ne menyre aksidentale nga mjetet e transportit. Per kete keshillohet te merren masa emergjente pastrimi.
UJE	Ndotje e ujerave siperfaqesore dhe ne ujera nentokesore	Nuk ka ndotje te ujerave nga ushtrimi i ketij aktiviteti. Ujerat sanitare shkarkohen ne kanalizimet e zones.
AJER	Emisione gazesh	Kontroll periodik i gjeneratorit. Monitorim i vazhdueshem i gazeve, por keto jane ne vlere te uleta pasi gjeneratori perdoret shume rralle, ne rast te mungeses se energjise elektrike.
	Zhurme, vibrime	Zhurma ne kete subjekt ka vetem gjate furnizimit te makinave me karburant dhe gjate procesit te furnizimit te depozitave me karburant nga autobotet perkatese. Aktiviteti nuk shoqerohet me nivel te larte te zhurmes.
MJEDISI BIOLOGJIK	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i karburantit
MBETJET	Menaxhimi I mbetjeve	<i>Mbetje urbane nga aktiviteti i punonjesve:</i> Mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti jane mbetje te perziera urbane qe dalin nga aktiviteti i punonjesve. Mbetjet e perziera urbane

		grumbullohen dhe me pas dergohen ne vendet e percaktuara nga Njesia Vendore. Mbetjet e llumrave ne depozita do te terhiqen nga operatore te licensuar me te cilet subjekti do te lidhe kontrate.
MJEDISI HUMAN	Shqetesim te banoreve te zones dhe subjekteve perreth	Subjekti ndodhet ne afersi te rruges ne nje hapësire ku kalojne vazhdimisht makina duke mos sjelle ndikime negative mbi popullesine qe jeton ne afersi te zones.
NDIKIME TE TJERA	Konsumi i energjise	Energjia qe do te perdoret eshte energjia elektrike e cila merret nga rrjeti.
	Konsumi i ujit	Furnizimi me uje do behet nga Ujesjelles Kanalizime I zones.
	Siguria dhe ndikime ne shendet	Me qellim per te siguruar nje nderhyrje te shpejte ne rast zjarri, subjekti do te marre masa per te vendosur fikese zjarri. Realizim i takimeve me stafin per te perballuar situata emergjente dhe vendosjen e posterave sensibilizues dhe njoftues. Punonjesit para se te punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje libreze shendetesore, e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik.

6. MENAXHIMI I MBETJEVE TE GJENERUARA

Mbetjet qe gjenerohen gjate ushtrimit te ketij aktiviteti jane mbetje te ngurta urbane dhe mbetje llumrash nga depozitat e lendeve djegese.

Mbetje te ngurta urbane - Tipet e mbetjeve me kodet 20 01 01, 20 01 02 dhe 20 03 01 do te gjenerohen nga aktiviteti I punonjesve. Brenda territorit te intalimit jane te vendosuar kontiniere te vegjel (kosha) per hedhjen e mbeturinave dhe me pas depozitohen ne piken e grumbullimit te caktuar nga Njesia e Qeverisjes Vendore. Operatori per stafin ka vendosur edhe kontiniere me ngjyra ne menyre qe mbetjet te diferencohen qe ne burim. Kontinieret do te pastrohen ne menyre te vazhdueshme nga punonjesit e mirembajtjes.

Mbetje te rrezikshme - Mbetjet me kod 13 05 02* do te terhiqen nga operatore te licensuar me te cilet subjekti do te lidhe kontrate per trajtimin/asgjesimin e metejshem te tyre.

PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE

Emertimi i mbetjes	Kodi i mbetjes	Burimi i gjenerimit te mbetjeve	Trajtim i metejshe me ne vendndodhje	Menaxhimi i mbetjeve dhe masat e marra	Personi pergjegjes
Leter, karton	20 01 01	Aktiviteti i punonjesve	Nuk kryhet trajtim i metejshe me ne vendndodhje	Vendosja e koshave me 3 ngjyra, ne menyre qe te behet edhe diferencimi qe ne burim i mbetjeve.	Prezantimi i masave eshte pergjegjesi e Administratorit dhe pergjegjesit
Qelq	20 01 02				
Mbetjet e perziera urbane	20 01 39			Evadimi ne kontiniere te posacem te mbyllur per te evituar gjenerim e aromave te pakendeshme. Pastrimi i shpeshte i konteniereve pa arritur kapacitetin maksimal te mbajtjes. Depozitimi i mbetjeve ne vendin e percaktuar nga Njesia e Qeverisjes Vendore ne fund te cdo dite pune.	Zbatimi me perpikmeri i masave eshte pergjegjesi e te gjithe punonjesve per mbarevajtjen e menaxhimit te integruar te mbetjeve.
Llumra nga separatoret uje/naftë	13 05 02*	Depozitat e karburanteve	Nuk kryhet trajtim I metejshe me ne vendndodhje	Depozitat u nenshtrohen pastrimit periodik nga operatore te licensuar, te cilet bejne dhe terheqjen e llumrave per t'I trajtuar/asgjesuar me pas.	Depozitat u nenshtrohen pastrimit periodik nga operatore te licensuar, te cilet bejne dhe terheqjen e llumrave per t'I trajtuar/asgjesuar me pas.

“D I E Z E L A” SH.P.K.

Administrator
Brikena Mersinaj